



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 shkurt 2018
Nr. ref.: KI 1192/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI152/17

Parashtrues

Shaqir Totaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, A. A. U. ZH. nr. 63/2017, i 7 dhjetorit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Shaqir Totaj nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. A. U. ZH. nr. 63/2017, të 7 dhjetorit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartpërmendur, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës të garantuar me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 3 [Parimet themelore] të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për Zgjedhjet Lokale).
4. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) *“të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e punës së Kryetarit të zgjedhur të Komunës së Prizrenit, në pritisje të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.”*

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullat 29 dhe 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 15 dhjetor 2017, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Në të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 19 dhjetor 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ai që, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, të qartësojë nëse kërkesën e ka dorëzuar si kërkesë individuale në emrin e tij. Po ashtu, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Në po të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Partinë Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: PDK), si dhe z. Mytaher Haskuka, kandidat i Lëvizjes VETËVENDOSJE! për Kryetar të Komunës së Prizrenit në zgjedhjet lokale të vitit 2017 (në cilësinë e palëve të interesuara), për regjistrimin e kërkesës. Gjykata iu dërgoi atyre nga një kopje të kërkesës si dhe i ftoj që, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, të dorëzojnë komentet e tyre eventuale përkitazi me kërkesën.
10. Më 26 dhjetor 2017, brenda afatit të përcaktuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi sqarimin e kërkuar në Gjykatë.

11. Në po të njëjtën ditë, z. Mytaher Haskuka dorëzoi komentet e tij përmes postës elektronike. Brenda afatit të përcaktuar, PDK nuk dorëzoi ndonjë koment.
12. Më 29 dhjetor 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës, z. Mytaher Haskuka dhe PDK-në, për pranimin e sqarimit dhe komenteve përkatëse (si dhe iu dërgoi atyre nga një kopje të sqarimit dhe komenteve).
13. Më 17 janar 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 22 tetor 2017, u mbajt raundi i parë i zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës. Parashtruesi i kërkesës ishte kandidat i PDK-së për Kryetar të Komunës së Prizrenit.
15. Rezultatet përfundimtare të raundit të parë zgjedhor përcaktuan se gara për Kryetar të Komunës së Prizrenit do të vendosej nga rezultati i raundit të dytë zgjedhor (balotazhit), që do të zhvillohej në mes të dy kandidatëve me më së shumti vota në raundin e parë, përkatësisht në mes të parashtruesit të kërkesës, z. Shaqir Totaj nga PDK dhe z. Mytaher Haskuka nga Lëvizja VETËVENDOSJE!.
16. Më 19 nëntor 2017, u mbajt raundi i dytë i zgjedhjeve lokale, ku për Kryetar të Komunës së Prizrenit garuan dy kandidatët e lartpërmendur.
17. Më 29 nëntor 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpalli rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të raundit të dytë për Kryetar të Komunës së Prizrenit. Sipas këtyre rezultateve, parashtruesi i kërkesës, z. Shaqir Totaj, kishte marrë 49.64% të votave; ndërsa, z. Mytaher Haskuka kishte marrë 50.36% të votave.
18. Më 30 nëntor 2017, PDK, përmes përfaqësuesit të saj z. Gani Koci, u ankua në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (në tekstin e mëtejme: PZAP), duke kërkuar *“që të hetohen, numërohen, fletëvotimet dhe materialet e tjera zgjedhore, dhe pas vërtetimit të fakteve për cenim të procesit zgjedhor në ditën e votimit, të anulohet rezultati zgjedhor dhe të urdhërohet Komisioni Qendror Zgjedhor për ta përsëritur votimin në Komunën e Prizrenit”*.
19. Më 1 dhjetor 2017, PZAP, me Vendimin ZL. Anr. 1124/2017, hodhi poshtë ankesën e PDK-së si të palejuar, me arsyetimin si në vijim:

“Apelin e parashtruar nga Partia Demokratike e Kosovës [...] paneli e ka trajtuar dhe proceduar në këtë fazë të procesit zgjedhor si apel, në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 3 par. 8 Rregullës nr.02/2015, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it[...].

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së apelit, në kuptim të nenit 117 të LZP-së [Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme], gjeti se pretendimet e parashtruesit të apelit në këtë fazë të procesit zgjedhor janë të palejueshme, për këto arsye:

Siç është përcaktuar me LZP dhe me Rregulla Zgjedhore, secila fazë e procesit zgjedhor, i ka afatet e caktuara ligjore, për të parashtruar ankesa dhe apele në PZAP, që ndërlidhen me fazën e procesit zgjedhor, që është duke u zhvilluar. Në këtë rast konkret, tani jemi në fazën e procesit zgjedhor, pas publikimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve lokale për raundin e dytë, të mbajtura më datë 19.11.2017, për kryetarë të komunave. Paneli vlerëson se kjo fazë e procesit zgjedhor, është e ankimueshme vetëm sa i përket vendimit të KQZ-së [Komisionit Qendror Zgjedhor] pas shpalljes së rezultatit përfundimtar, për kryetarë të komunave dhe atë për parregullsitë e shkaktuara gjatë administrimit të të dhënave në QNR, mospërputhjet e FRP-ve, FRK-ve, dhe provave që eventualisht i sjell pala që ka interes ligjor, e të cilat prova nuk përputhen me rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, apo parregullsitë të cilat kanë qenë të ditura publikisht dhe që janë konsideruar nga paneli se mund të kenë ndikim drejtpërdrejt në rezultat final dhe që minojnë procesin zgjedhor, por nuk janë përmirësuar respektivisht nuk janë eliminuar nga KQZ-ja [...]. Pretendimet ankimore të parashtrueses së apelit [...] për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale të mbajtura me datë 19.11.2017 [...] në këtë fazë të procesit zgjedhor janë të palejueshme, sepse për të gjitha parregullsitë që ndërlidhen me ditën e votimit, afati për të parashtruar ankesë në PZAP, ka qenë 24 orë nga mbyllja e qendrave të votimit, në këtë rast afati për të parashtruar ankesë në PZAP ka qenë me datë 20.11.2017, në ora 19:00.”

20. Më 5 dhjetor 2017, PDK parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme përmes së cilës kontestoi ligjshmërinë e Vendimit të lartpërmendur të PZAP-it, me propozimin që: ankesa të pranohet; të anulohet Vendimi i PZAP-it; të kërkohet nga PZAP-i që të rishqyrtojë Vendimin ose të anulohen rezultatet zgjedhore dhe të urdhërohet KQZ-ja që të përsërisë votimin në Komunën e Prizrenit.
21. Më 7 dhjetor 2017, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin A. A. U. ZH. nr. 63/2017, e refuzoi si të pabazuar ankesën e paraqitur nga PDK, me arsyetimin si në vijim:

“Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren [...].

Gjykata vlerësoi se janë të pabazuara pretendimet e subjektit politik PDK, paraqitur në ankesën ndaj vendimit të kontestuar të PZAP-it [...]. Parashtruesi i ankesës [PDK] nuk i ka argumentuar me asnjë provë pretendimet e veta, kurse ato prova, të cilave u referohet, nuk janë me ndikim në marrjen e një vendimi tjetër në këtë çështje juridike [...].

Kjo Gjykatë, po ashtu, vlerëson se të gjitha parregullsitë që ndërlidhen me ditën e votimit, pra prej datës 19.11.2017, afati për të parashtruar ankesë në PZAP ka qenë 24 orë nga mbyllja e qendrave të votimit, e në këtë kuptim, sipas nenit 119.1 LZP nr.03/L-073 i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.03/L-256 parashihet se personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP, ose të drejtat e të cilat janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP do të vendos ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa.

PZAP ka vërtetuar drejt se parregullsitë gjatë procesit zgjedhor, në ditën e votimit, për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale të datës 19.11.2017 drejtpërdrejt të ndërlidhura me ditën e votimit, e që afati për të parashtruar ankesë ishte 24 orë nga mbyllja e qendrave të votimit, në këtë rast afati ka qenë deri në 20.11.2017, në ora 19:00.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se PZAP-i ka vendos drejt me rastin e hedhjes së ankesës së subjektit politik PDK – si të palejuar, pasi afati i ankimit ishte 20.11.2017, deri në ora 19:00, kurse ankesa është parashtruar me datën 30.11.2017.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, e cila konstatoi se edhe e drejta materiale, po ashtu, është zbatuar drejt. Nisur nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj nuk i pranoi pretendimet ankimore të tij, ngaqë janë pa ndikim në konstatimin e një gjendjeje tjetër faktike nga ajo që ka vërtetuar PZAP”.

22. Më 11 dhjetor 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për raundin e dytë për Kryetar të Komunës së Prizrenit, si dhe disa komunave të tjera.

Sqarimi i dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës

23. Me rastin e njoftimit të parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës, Gjykata kishte kërkuar nga ai që të bëjë një qartësim me sa vijon:

“Nëpërmjet kërkesës tuaj, ju kontestoni Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A.A. U.ZH. nr. 63/2017, të 7 dhjetorit 2017, që është nxjerrë pas ankesës së parashtruar nga Partia Demokratike e Kosovës [...]. Ju lutemi që të qartësoni nëse kërkesën e keni dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese si kërkesë individuale në emrin tuaj [...]”.

24. Në përgjigjen e tij drejtuar Gjykatës, parashtruesi i kërkesës sqaroi si në vijim:

“Pas njoftimit tuaj për regjistrimin e kërkesës KI152/17 dhe kërkesës për qartësim, në vijim qartësoj se kërkesa ime duhet të trajtohet nga Gjykata Kushtetuese si kërkesë individuale në emrin tim”.

Komentet e dorëzuara nga pala e interesuar, z. Mytaher Haskuka

25. Në cilësi të palës së interesuar, z. Mytaher Haskuka ka dorëzuar komente lidhur me pranueshmërinë e kërkesës; pranueshmërinë e kërkesës për masë të përkohshme; si dhe për meritat e kërkesës.
26. Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, në aspektin procedural, z. Mytaher Haskuka, pohon se “parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike për shkak se ‘PDK’ më cilësinë e personit juridik ka shfrytëzuar apelet në PZAP dhe në Gjykatën Supreme”. Më tutje, z. Mytaher Haskuka thekson se “PDK në cilësinë e personit juridik, i përfaqësuar nga personi i caktuar, nuk ka dorëzuar apo firmosur ankesë, apo parashtresë

në emër të parashtruesit, (Shaqir Totaj) në apelet e përcaktuara me nenin 118.4 dhe 119.1 të LZP-së [Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme] dhe as në Gjykatën Kushtetuese”.

27. Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës për masë të përkohshme, z. Mytaher Haskuka deklaroi se: *“Parashtruesi, nuk ka mundur në asnjë çast të vetëm të mbështesë kërkesën për masë të përkohshme me prova apo të paraqesë fakte të cilat do të krijonin besim dhe bindje në Gjykatën Kushtetuese për ndërmarrjen e një mase të tillë”.*
28. Përkitazi me meritat e kërkesës, z. Mytaher Haskuka deklaroi se: *“[...] PZAP dhe Gjykata Supreme kanë vendosur drejt në rastin e hedhjes së ankesës së subjektit politik PDK, si të palejuar dhe të pabazuar”. Më tutje, ai thekson se: “[...] mosrespektimi i afatit dhe mosmbështetja e pretendimeve me prova të caktuara, nuk reflekton cenim të nenit 45 të Kushtetutës, konkretisht të drejtës pasive zgjedhore”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] i Kushtetutës si dhe neni 3 [Parimet themelore] i Ligjit për Zgjedhjet Lokale.
30. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme nuk ka arritur *“të provojë dhe të verifikojë faktet dhe provat e ankuesit, e të cilat ndërlidhen dhe implikojnë drejtpërsëdrejti me interesin ligjor të parashtruesit të saj, dhe janë po ashtu vendimtare në cilësimin ose jo të shkeljes së të drejtës kushtetuese, të drejtës pasive zgjedhore (e drejta për të qenë i zgjedhur) [...]”.*
31. Më tej, parashtruesi thekson se, duke mos shqyrtuar ankesën, PZAP-i *“[...] ka anashkaluar fakte dhe prova vendimtare”. Sipas parashtruesit, “përkundër që PDK kishte ushtruar ankesë, bazuar në fakte dhe prova që ndërlidheshin me procesin zgjedhor dhe numërimin [...] PZAP me vendimin për hedhje poshtë si të palejuar të ankesës së PDK-së e kishte bazuar në faktin e mosparaqitjes së ankesës brenda 24 orëve nga mbyllja e qendrave të numërimit, duke mos shqyrtuar në mënyrë meritore këtë ankesë, edhe pse një pjesë e konsiderueshme e provave dhe fakteve të saj, ndërlidheshin ekskluzivisht, me procesin e numërimit të votave me kusht, votave me postë dhe votave të personave me nevoja të veçanta, i cili proces ka ndodhur pas shpalljes së rezultateve preliminare nga KQZ”.*
32. Për më tepër, parashtruesi pretendon se PZAP-i ka *“zbatuar gabimisht nenin 119.1 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256” meqë e kishte “konsideruar të paefektshëm dhe jorelevant cilindo fakt ose provë që vërteton shkelje sipas ligjit, edhe pas ditës së votimit [...]”.* Sipas parashtruesit, shkeljet e tilla *“rezultojnë ose mund të rezultojnë me cenimin e parimeve themelore si dhe të drejtës kushtetuese dhe ligjore, të drejtës pasive zgjedhore (e drejta për të qenë i zgjedhur)”.*

33. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të bëhet: “Vlerësimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Aktgjykimit A. A. U. ZH. nr. 63/2017 të datës 07.12.2017 të Gjykatës Supreme të Kosovës për refuzimin si të pabazuar të ankesës A.ZL.NR.1124/2017 të datës 01.12.2017, të parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës “PDK” kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa “PZAP” për shkak të keqpërdorimeve gjatë procesit zgjedhor, në ditën e votimit, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale [...]”.
34. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, kërkon nga Gjykata “të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e punës së Kryetarit të zgjedhur të Komunës së Prizrenit, në pritje të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese”.

Dispozitat relevante ligjore të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës të ndryshuar sipas Ligjit nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

Neni 118 [Vendimet]

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet. [...]

118.4 Mund të apelohej vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda 24 (njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme vendos në afatin prej 72 (shtatëdhjetëdy) orëve pas paraqitjes së apelit.

Neni 119 [Ankesat]

119.1 Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa [...].

Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore.
36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

37. Më tej, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, i cili përcakton:

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

38. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafit (1) (b) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjyimit të kontestuar, [...]

39. Gjykata rikujton se kërkesa është parashtruar, si kërkesë individuale, nga z. Shaqir Totaj, i cili kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme, A.A. U.ZH. nr. 63/2017, të 7 dhjetorit 2017. Ky aktgjykim është nxjerrë nga Gjykata Supreme pas ankesës që PDK, në cilësinë e subjektit politik dhe rrjedhimisht në cilësinë e personit juridik, ka parashtruar kundër Vendimit Anr. 1124/2017 të PZAP-it, të 1 dhjetorit 2017.
40. Fakti që parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij kushtetuese në cilësinë e personit fizik dhe në emrin e tij personal, vërtetohet edhe nga vetë sqarimi i tij dorëzuar në Gjykatë. Këtë sqarim, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi pas kërkesës së Gjykatës drejtuar atij. Në përgjigjen e tij, parashtruesi i kërkesës thekson se *“kërkesa ime duhet të trajtohet nga Gjykata Kushtetuese si kërkesë individuale në emrin tim”*.
41. Gjykata, po ashtu, vë në pah se në kërkesën e dorëzuar në Gjykatë, parashtruesi shprehet se *“nuk ka pasur mjete tjera të rregullta juridike që nuk i kemi shfrytëzuar”*, duke aluduar në mjetet juridike të shteruara nga PDK, si palë e vetme procedurale pranë PZAP-it dhe Gjykatës Supreme.
42. Megjithatë, nga shkresat e lëndës, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka shteruar asnjë mjet juridik në emrin e tij personal, pra si person fizik apo si *“person i cili ka interes ligjor”*, pranë PZAP-it apo pranë Gjykatës Supreme, para se të dorëzonte kërkesën e tanishme në Gjykatën Kushtetuese. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk përmendet asnjëherë në aktgjykimin e kontestuar e as në vendimin e lartpërmendur të PZAP-it.

43. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës ka pasur mundësi ligjore që si person fizik, apo si *“person i cili ka interes ligjor”*, të paraqiste ankesat dhe apelet përkatëse për sa i përket pretendimeve të tij për *“shkelje të të drejtës pasive zgjedhore (e drejta për të qenë i zgjedhur)”*. Ai ka mundur që pretendimet për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese t'i paraqes pranë PZAP-it dhe Gjykatës Supreme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vetëm pasi që të kishte shteruar mjetet e tilla juridike ai do të mund të paraqiste, në Gjykatën Kushtetuese, një kërkesë individuale për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimeve në fjalë, të PZAP-it dhe Gjykatës Supreme, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit.
44. Në dritën e fakteve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se parashtuesi i kërkesës nuk i ka shteruar mjetet juridike që i ka pasur në dispozicion, të parapara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, nr. KI73/09, *Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror i Zgjedhjeve*, Aktvendim për papranueshmëri i 24 marsit 2010, paragrafët 28-36).
45. Gjykata rikujton se rregulli i shterimit të mjeteve juridike është pasqyrim i parimit të subsidiaritetit, si parim themelor në gjyqësinë kushtetuese, i cili ka për qëllim që t'i ofrojë gjykatave të rregullta, apo autoriteteve publike përkatëse, mundësinë për të parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar kushtetuese (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese rasti KI41/09, *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 janarit 2010, shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së *Selmouni kundër Francës*, *Ibidem*, paragrafi 74).
46. Si përfundim, Gjykata konstaton që kërkesa është parashtuar para se parashtuesi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike dhe, si e tillë, duhet të deklarohet e papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

47. Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës gjithashtu kërkoi nga Gjykata *“të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e punës së Kryetarit të zgjedhur të Komunës së Prizrenit, në pritje të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.”*
48. Për të mbështetur këtë kërkesë, parashtuesi thekson se *“masa e përkohshme është në interes të publikut, sepse mungesa e saj mund të shkaktojë një dëm të pakthyeshëm në funksionimin e institucionit – Komunës së Prizrenit, si dhe demokracisë në Republikën e Kosovës.”*
49. Gjykata përsëritë konstatimin se kërkesa e parashtuesit të kërkesës u deklarua e papranueshme për shkak se ai nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike.
50. Prandaj, në pajtim me konstatimet e mësipërme si dhe në pajtim me nenin 116 (2) të Kushtetutës, nenin 27 (1) të Ligjit dhe rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, më 17 janar 2018njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi